



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 42

2000

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8700 datë 23.11.2000	Për anëtarësimin e laboratorit kombëtar të testimit të farave dhe fidanëve në shoqatën ndërkombëtare të testimit të farave (ISTA)	1915
Ligj nr.8712 datë 15.12.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 “Për miratimin e nomenklaturës dhe tarifës doganore”, ndryshuar me ligjin nr.8558, datë 22.12.1999	1921
Ligj nr.8713 datë 15.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”	1924

L I G J
Nr.8700, datë 23.11.2000

**PËR ANËTARËSIMIN E LABORATORIT KOMBËTAR TË TESTIMIT TË FARAVE DHE
FIDANËVE NË SHOQATËN NDËRKOMBËTARE TË TESTIMIT TË FARAVE (ISTA)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Laboratori Kombëtar të Testimit të Farave dhe Fidanëve pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit anëtarësohet në Shoqatën Ndërkombëtare të Testimit të Farave (ISTA), si autoritet i emëruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për pagesën e kuotizimit vjetor pranë kësaj shoqate.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2825, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

STATUT
I SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË TESTIMIT TË FARAVE

Miraturar në mbledhjen e jashtëzakonshme në Uashington në Qershor 1971, përmirësuar në mbledhjet e zakonshme në Varshavë 1974, Brisbanë 1986 dhe Kopenhagen 1995.

Neni 1

Emri

Shoqata do të njihet si Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farave, më poshtë e quajtur “Shoqatë”.

Neni 2

Selia

Selia e Shoqatës do të jetë zyra e thesarit dhe sekretaria. Komiteti Ekzekutiv mund të ngrejë zyra gjithashtu në vende të tjera që do të vendosen nga Komiteti Ekzekutiv herë pas here, për të ndihmuar në zbatimin e qëllimeve të Shoqatës.

Neni 3

Objektivat

a. Objekti parësor i shoqatës është të zhvillojë, miratojë dhe të bëjë procedurat standarde për kampionizimin dhe testimin e farërave dhe të nxisë zbatimin njëlloj të këtyre procedurave për vlerësimin e farërave që shkëmbehen në rrugë tregëtare.

b. Objektivat dytësore të Shoqatës janë nxitja aktive për kërkimin shkencor në të gjitha fushat e shkencës dhe të teknologjisë së farërave, duke përfshirë kampionizimin, testimin, ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e farërave, nxitja e çertifikimit të varieteteve, të marrë pjesë në konferenca dhe kurse kualifikimi që synojnë në çuarjen më tej të këtyre objektivave, si dhe të vendosë e të mbajë lidhje me organizatat e tjera, që kanë interesa të përbashkëta në fushën e farërave.

Neni 4

Autoriteti i emëruar

a. Autoriteti i emëruar është një autoritet që emërohet nga një qeveri për të vepruar në emër të saj në përcaktimin e anëtarëve të emëruar në lidhje me Shoqatën, në veçanti në lidhje me akreditimin e laboratorëve antarë.

Antarësimi

b. Anëtarët e emëruar janë persona dhe/ose laboratorët e angazhuar në shkencën ose praktikën e testimit të farës apo në kontrollin teknik të aktivitetëve të tilla, të cilët janë caktuar nga autoriteti i emëruar i tyre respektiv dhe pranuar nga Shoqata për të marrë pjesën e çështjet e Shoqatës.

c. Një anëtar është një person apo laborator i farërave, i cili mbështet Shoqatën dhe objektivat e saj dhe pranohet nga Shoqata.

d. Anëtarët e emëruar kanë të drejtën që të votojnë në mbledhjet e Shoqatës, në përputhje me klauzolat e nenit 9.

Laboratori i akredituar

e. Një Laborator i akredituar është një laborator anëtar i akredituar nga Komiteti Ekzekutiv në përputhje me standardet e akreditimit të aprovuara në bazë të nenit 7 (c) (14) të statutit dhe që plotësojnë kërkesat për pavarësi të dhëna në këto standarde.

Neni 5

Drejtuesit

a. Nëpunësit e Shoqatës do të jenë:

- Presidenti
- Zëvendëspresidenti i parë
- Zëvendëspresidenti i dytë
- Sekretar-arkëtari

b. Kohëzgjatja e detyrës së Presidentit dhe e drejtuesve të tjerë do të jetë si rezultat i azhurnimit të mbledhjes së zakonshme në të cilën ato janë caktuar për azhurnimin e mbledhjes tjetër të zakonshme.

c. Me përfundim të kohëzgjatjes së detyrës, Presidenti i cili largohet nga detyra nuk është i përshtatshëm në të ardhmen për t'u rizgjedhur si president apo edhe si zëvendëspresident i parë.

Neni 6

Funksionet e drejtuesve

a. Presidenti thërret dhe kryeson mbledhjet e Shoqatës dhe ato të Komitetit Ekzekutiv. Presidenti do të jetë një anëtar zyrtar i të gjithë komiteteve të Shoqatës.

b. Zëvendëspresidenti i parë do të qëndrojë pranë Presidentit dhe në rast paaftësie të Presidentit për të shërbyer, do të kryejë detyra të tilla që kanë të bëjnë me funksionin e Presidentit.

c. Zëvendëspresidenti i dytë do të qëndrojë pranë Presidentit dhe në rast paaftësie të Presidentit dhe Zëvendëspresidentit të parë, do të kryejë detyra të tilla që kanë të bëjnë me funksionin

e Presidentit.

d. Sekretar-arkëtari, me kërkesë të Presidentit, do të mbledhë të gjitha mbledhjet e Shoqatës dhe të Komitetit Ekzekutiv, do të ndjek dhe do të mbajë dokumentet e të gjitha mbledhjeve, dhe do të kryejë të gjitha detyrat e tjera të sekretarit.

Sekretar-arkëtari do të kryejë funksione të tilla, që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe shpenzimet e fondeve që i përkasin Shoqatës, që do të autorizohen nga Komiteti Ekzekutiv.

Neni 7

Komiteti Ekzekutiv

a. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga Presidenti, Zëvendëspresidenti i parë, Zëvendëspresidenti i dytë dhe sekretar-arkëtari, së bashku me 7 anëtarë, të cilët do të jenë anëtarë të emëruar.

b. Kohëzgjatja e funksionit të anëtarëve do të jetë e njëjtë me atë të drejtuesve siç jepet në nenin 5 (b).

c. Funksionet e Komitetit Ekzekutiv do të jenë si më poshtë:

1. Komiteti Ekzekutiv do të administrojë dhe do të drejtojë punët e Shoqatës në përputhje me klauzolat e këtij statuti dhe në vendimet e marra nga Shoqata në mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

2. Në rastin e pushimit të funksionarëve apo të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv, anëtarët e mbetur të Komitetit janë të plotfuqishëm për të emëruar zëvendësues për të shërbyer deri në mbledhjen tjetër të zakonshme të shoqatës.

3. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv do të thirren në përputhje me klauzolat e nenit 6 ose me kërkesën me shkrim të gjashtë apo më shumë anëtarëve të saj.

4. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm për të formuar komitete për të studiuar dhe raportuar mbi problemet, që i përkasin punëve të shoqatës, për të vendosur dhe për të mbajtur lidhje me organizata të tjera, që mund të kenë lidhje me objektivat e Shoqatës, dhe planifikojë dhe miratojnë konferenca e kurse kualifikimi që synojnë çuarjen më tej të objektivave të Shoqatës.

5. Përgjegjësia për anën financiare të Shoqatës i takon Komitetit Ekzekutiv.

6. Komiteti Ekzekutiv do të emërojë një redaktor për botimin e “Shkenca dhe teknologjia e farërave”.

7. Komiteti Ekzekutiv do të miratojë përkthimet e rregullat ndërkombëtare për testimin e farërave, kur lind nevoja, pasi të jetë konsultuar me komitetet teknike përkatëse.

8. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm të emërojë, në çdo mbledhje të zakonshme, një dëgjues, i cili nuk do të jetë një funksionar apo një anëtar i Komitetit Ekzekutiv dhe nuk është e nevojshme të jetë anëtar i emëruar.

9. Komiteti Ekzekutiv do të përkthejë për secilin mbledhje të zakonshme të shoqatës një përmbledhje të plotë të punimeve të saj dhe të aktiviteteve të Shoqatës dhe do të paraqesë mbledhjes së Shoqatës një deklaratë kontrollit të llogarive deri në fund të vitit kalendarik të mëparshëm.

10. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm të thërrasë dhe të mbledhë një konventë ndërkombëtare të testimin të farërave në lidhje me mbledhjen e zakonshme të shoqatës. Të gjitha konventat e tilla do t'i kushtohen leximit të dokumenteve shkencore, diskutimeve dhe demonstrimeve në kërkimet shkencore për farërat dhe të subjekteve të tilla, që kanë lidhje dhe i përkasin objektivave të Shoqatës.

11. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm të punësojë dhe të paguajë për asistencë të tillë kujdestarie kur konsiderohet e domosdoshme.

12. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm të miratojë pranimin e anëtarëve të rinj të Shoqatës.

13. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm të ngarkojë trajtimin e problemeve të veçanta.

14. Komiteti Ekzekutiv është i plotfuqishëm të aprovojë dhe botojë standardet e akreditimit dhe në marrëveshje me autoritetin e caktuar, të akreditojë laborator anëtar dhe të autorizojë laboratorë të tillë për të shpërndarë certifikata të shoqatës ndërkombëtare të testimin të farërave.

15. Komiteti Ekzekutiv do të vendosë përpara një mbledhjeje të zakonshme vendin e mbledhjes tjetër të zakonshme të Shoqatës.

16. Gjashtë anëtarë të Komitetit Ekzekutiv do të përbëjnë quorum. Midis mbledhjeve, biznesi do të kryhet nga korrespondenca në të cilën së paku 6 anëtarë duhet të marrin pjesë për të bërë të

mundur një vendim.

Neni 8 **Emërtimi dhe zgjedhja**

a. Në secilën mbledhje të zakonshme të Shoqatës, Zëvendëspresidenti i parë i mëparshëm, me kushtin që personi të jetë zgjedhur në mënyrë të përshtatshme për atë funksion në mbledhjen e zakonshme, të mëparshme emërtohet president për periudhën e mëpasme pa zgjidhje të mëtejshme. Në rast se në ndonjë mbledhje të zakonshme për çfarëdo arsye, Zëvendëspresidenti i parë i mëparshëm nuk është i përshtatshëm për t'u emërtuar president, funksioni i presidentit do të arrihet me zgjedhje sipas procedurës së përshkruar për funksionet e tjerë në paragrafet (b) dhe (c) të këtij neni.

b. Subjekti i klauzolave të paragrafit 9 (a) të këtij neni, zgjedhja e funksioneve dhe të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv, mund të propozohet vetëm nga anëtarët e emëruar. Emërimet tilla do të jenë me shkrim dhe për më tepër të mbështetura edhe nga një i dytë (të dy të jenë anëtarë të emëruar) dhe duhet të merret nga sekretar-arkëtar jo më vonë se një ditë përpara mbledhjes së zakonshme në të cilën do të mbahen zgjedhjet.

Neni 9 **Votimi**

a. Pavarësisht nga numri i anëtarëve të emëruar nga një Qeveri e vetme, vetëm një votë do të hidhet në emër të kësaj Qeverie.

b. Kategoritë e mëparshme të propozimeve kërkojnë për miratim dy të tretat e shumicës së atyre që votojnë, propozimet për të ndryshuar këtë statut, propozimet për të shpërndarë Shoqatën dhe propozimet që ngrihen gjatë mbledhjeve dhe që kanë të bëjnë me azhurnim të përkohshëm, mbylljen e debatit apo me shtyrjen e veprimit. Të tilla propozime të tjera kërkojnë një shumicë të thjeshtë të atyre që votojnë për miratim.

c. Për çështje urgjente të përcaktuara nga Komiteti Ekzekutiv dhe në të cilat Komiteti Ekzekutiv nuk është i autorizuar të veprojë, anëtarët me të drejtë vote mund të kërkojnë nga sekretar-arkëtari, të votojnë me korrespondencë gjatë periudhës midis mbledhjeve të zakonshme të Shoqatës në përputhje me paragrafin (a) dhe (b) të këtij neni.

Neni 10 **Takimet e Shoqatës**

a. Takimi i zakonshëm i anëtarëve të Shoqatës mbahet si rregull çdo 3 vjet, por takime të jashtëzakonshme mund të mbahen kur konsiderohen të nevojshme nga Komiteti Ekzekutiv ose kur kërkohet nga dy të tretat e anëtarëve të emëruar.

b. Çështjet në mosmarrëveshje në takime të Shoqatës do të referohen për votim.

c. Në rast se votimi bllokohet, Presidenti ose në mungesë të tij zëvendëspresidenti, do të kenë një votë vendimore në takimet e Shoqatës dhe të Komitetit Ekzekutiv. Në të gjitha komitetet e tjera të Shoqatës në rast bllokimi, kryetari veprues do të ketë një votë vendimore.

d. Anëtarët e emëruar, të emëruar nga 40% e autoriteteve të emëruara do të përbëjnë një quorum në takimet e Shoqatës. Në përcaktimin e përqindjes së grupeve më pak se 0.50% do të zbriten dhe ato 0.50, ose më të mëdha do të shikohen si një numër i plotë.

e. Programi për takimin e zakonshëm të Shoqatës do të përfshijë:

1. Rendi i ditës
2. Fjala e Kryetarit
3. Antarët e emëruar
4. Leximi dhe miratimi i protokollit
5. Raporti i komitetit
6. Raporti i thesarit
7. Shkarkimi i Komitetit Ekzekutiv
8. Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve
9. Zgjedhja e funksioneve dhe anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv

10. Instalimi i funksionarëve të rinj
11. Shpallja e rendit dhe e datës për mbledhjen tjetër të zakonshme të shoqatës
12. Caktimi i detyrimeve vjetore
13. Ndonjë çështje tjetër e ngritur nga një anëtar, njoftimi i të cilit me shkrim është marrë nga sekretar-arkëtari së paku dy muaj përpara datës së mbledhjes
14. Ndonjë çështje tjetër e ngritur me miratimin e Komitetit Ekzekutiv
15. Fjala e mbylljes së Presidentit
16. Azhornimi

Neni 11

Financat

a. Pagesat e qerave që i përkasin Shoqërisë mund të bëhen vetëm në lidhje me çështjet që lidhen drejtpërsëdrejti me objektivat e shoqatës sipas klauzolave përkatëse në këtë statut.

b. Të ardhurat e Shoqatës do të vinë nga kuotizacionet vjetore, që paguhen nga Qeveritë, autoritetet e emëruara, antarët e emëruar, ose nga antarët, dhe nga pagesat dhe dhurimet e marra nga persona, organizata apo qeveri për qëllime specifike ose të përgjithshme.

c. Shuma e kuotizacionit vjetor për anëtarët e emëruar, antarët dhe laboratorët e akredituar do të vendoset për një periudhë së paku trevjeçare në një mbledhje të zakonshme të shoqatës, konsideratë e drejtë i jepet deklaratave të parashtruara në përputhje me nenin 7 (c) , (9) dhe paragrafin (g) të këtij neni. Njoftimet e propozimeve për të ndryshuar shkallën e kuotizacioneve vjetore do t'u dërgohen autoriteteve të emëruara, antarëve të emëruar dhe antarëve jo më vonë se gjashtë muaj përpara mbledhjes së zakonshme.

d. 1. Përfaqësimi i çdo anëtar të emëruar, kuotizacioni i të cilit është në detyrim të prapambetur për më shumë se 2 vjet, përfundon me kusht që njoftimi i drejtë i detyrimit të kuotizacionit të jetë dhënë nga sekretar-arkëtari.

d. 2. Antarësia e anëtarit, kuotizacioni i atij apo për atë, i cili është në detyrim të prapambetur për më tepër se dy vjet, do të përfundojë, me kusht që njoftimi i detyrimit të regjistrimit të jetë dhënë nga sekretar-antari.

e. Viti financiar do të jetë nga 1 janari deri në 31 dhjetor dhe regjistrimi për secilin vit financiar do të jetë i pagueshëm me 1 janar të atij viti.

f. Llogaritë e të gjitha parave të ardhura dhe të shpenzuara nga Shoqata do të mbahen nga sekretar-arkëtari.

g. Një deklaratë që tregon gjendjen financiare të Shoqatës, të shqyrtuar dhe të vërtetuar nga revizori, do të qarkullojë çdo vit për anëtarët e Shoqatës dhe do të botohet në "Shkenca dhe teknologjia e farës".

Neni 12

Amendamentet

Klauzolat e këtij statuti mund të ndryshohen si më poshtë:

1. Çdo propozim për të ndryshuar klauzolat e këtij statuti duhet të merret me shkrim nga sekretar-arkëtari jo më vonë se 4 muaj para datës së mbledhjes së shoqatës në të cilën do të diskutohet.

2. Sekretar-arkëtari do t'i komunikojë çdo propozim të tillë çdo anëtar të Shoqatës jo më vonë se tre muaj para datës së mbledhjes së Shoqatës dhe do të mbajë shënime që tregojnë evidentimin e këtyre komunikimeve.

3. Amendamentet e këtij statuti do të hyjnë në fuqi vetëm nëse ato do të gëzojnë mbështetjen e jo më pak se dy të tretave të antarëve të emëruar që votojnë në një mbledhje të Shoqatës me kusht që quorum të jetë i pranishëm.

Neni 13

Interpretimi

Në çfarëdo rasti, ku interpretimi i këtij statuti është i dyshimtë, teksti anglisht do të jetë i vlefshëm.

Neni 14
Shpërndarja e Shoqatës

a. Çdo qeveri mund të tërheqë nga Shoqata anëtarët e saj të emëruar duke dhënë njoftim për tërheqjen në çdo kohë. Njoftimi do t'i komunikohet sekretar-arkëtarit, i cili do të informojë të gjithë antarët e Shoqatës.

b. Nëse një qeveri deklaron në njoftimin e saj se tërheqja është për shkak se ajo nuk mund të pajtohet me një amendament të miratuar në nenin 12, kjo tërheqje do të bëhet efektive në datën e hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, me kusht që sekretar-arkëtari të ketë marrë njoftim jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e amendamentit. Tërheqja në çdo rrethanë tjetër do të bëhet efektive në fund të vitit kalendarik në të cilën është dhënë njoftimi për këtë qëllim.

c. Detyrimi financiar ndaj shoqatës i një qeverie, e cila ka dhënë njoftim për tërheqje do të përfshijë të gjithë vitin kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi, përveç rastit kur tërheqja është efektive në datën e hyrjes në fuqi të një amendamenti, si është përshkruar më sipër.

Qeveria nuk do të ketë përgjegjësi për nënshkrim pas asaj date.

L I G J
Nr. 8712, datë 15.12.2000

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8474, DATË 14.4.1999 “PËR MIRATIMIN E
NOMENKLATURËS DHE TARIFËS DOGANORE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8558,
DATË 22.12.1999**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999, “Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore”, ndryshuar me ligjin nr.8558, datë 22.12.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në krerët dhe nënkrerët e nomenklaturës së mallrave me tarifë doganore 18 për qind, tarifa doganore ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën doganore prej 15 për qind.

Neni 2

Në krerët dhe nënkrerët e nomenklaturës së mallrave me tarifë doganore prej 5 për qind, tarifa doganore ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën doganore prej 2 për qind.

Neni 3

Në seksionin I, kapitulli 2 me titull “Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit”, në kodet 0206 10 91; 0206 10 95; 0206 10 99; 0206 22 90; 0206 29 91; 0206 29 99; 0206 80 91; 0206 80 99; 0206 90 91; 0206 90 99, si dhe 0207 13 91; 0207 14 91; 0207 26 91; 0207 34 10; 0207 34 90; 0207

35 91; 0207 36 81; dhe 0207 36 85, tarifa doganore prej 18 për qind ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën doganore prej 10 për qind.

Neni 4

Kapitulli 12, kodi 12 06 00; 12 06 00 10; 12 06 00 91 dhe 12 06 0099, tarifa doganore bëhet 2 për qind.

Neni 5

Në seksionin IV, kapitulli 18 me titull “Kakao dhe përgatitja e kakaos”, i gjithë kapitulli bëhet me tarifë doganore 10 për qind.

Në seksionin IV, kapitulli 19 me titull “Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtesë ose qumështit, produktet e pastiçerisë ose të brumërave”, në kodet 1905 e në vazhdim, tarifa doganore bëhet 2 për qind.

Në seksionin VI, kapitulli 31 me titull “Plehëruesit”, në kodet 3103 10 dhe 3103 10 90, tarifa doganore bëhet 2 për qind.

Në seksionin VI, kapitulli 36 me titull “Eksplzivët; produktet piroteknike; shkrepset; lidhjet piroforike; preparatet e caktuara të djegshme”, në kodet 3601, 3602, 3603 dhe 3606, tarifa doganore prej 10 dhe 18 për qind ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën doganore prej 2 për qind.

Në seksionin VI, kapitulli 37 me titull “mallrat fotografike dhe kinematografike”, në kodet nga 3701 deri 3707 90 90 (përfshirë), tarifa doganore bëhet 2 për qind.

Në seksionin VI, kapitulli 38 me titull “Produkte të ndryshme kimike, në kodet nga 3801 deri në 3824 90 95 (përfshirë), tarifa doganore bëhet 2 për qind.

Neni 6

Për stimulimin e industrisë së cigareve në kodin 2403 91 00 “duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar”, në kodin 3501 “kaseinë, kaseinatet dhe derivatet e tjera të kaseinës; tutkall kaseine”, në kodin 3505 10 “dekstrina dhe niseshtetë e tjera të modifikuara”, në kodin 3505 20 “ngjitësat” dhe në kodin 3814 00 “solventet dhe trashësit e përbërë organikë, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; zhvendosësit e përgatitur të bojërave ose të llustrosësve”, tarifa doganore prej 18 për qind ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën doganore prej 10 për qind.

Neni 7

Në seksionin XI, kapitulli 57 me titull “Qilima dhe veshje të tjera të dyshemesë prej tekstili”, bëhet i gjithë me tarifë doganore prej 10 për qind.

Në seksionin XI, kapitulli 58 me titull “Pëlhura speciale të endura, pëlhura tekstile me xhufka; tantellat; tapiceritë; zbukurimet; qëndismat”, bëhet i gjithë me tarifë doganore prej 10 për qind.

Në seksionin XI, kapitulli 59 me titull “Pëlhura tekstile të ngopura, të veshura, të mbuluara ose të laminura; artikuj tekstilë të një lloji të përshtatshëm për përdorim industrial”, bëhet i gjithë me tarifë doganore prej 10 për qind.

Në seksionin XI, kapitulli 63 me titull “Artikuj të tjerë tekstilë të ndërtuar; grupet e artikujve tekstilë; veshjet e përdorura dhe artikuj tekstilë të përdorur; lecka mbeturinë”, kodet 6301 deri 6308 (përfshirë), bëhen me tarifë doganore prej 10 për qind.

Neni 8

Në seksionin VI, në kapitullin 34 me titull “Sapuni, agjentët organikë me veprim të sipërfaqshëm, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllët artificiale, dyllët e përgatitura...”, tarifa doganore e kodit 3402 20 “preparate të vendosura për shitje me pakicë”, përkatësisht kodet 3402 20 10 dhe 3402 20 90, ndryshohen duke u zëvendësuar me tarifën doganore prej 10 për qind.

Neni 9

“Kapitulli 48, kodet 48 01 00 deri 48 02 60 99 (përfshirë) tarifa doganore bëhet 2 për qind.”

Neni 10

Në seksionin XVII, kapitulli 87 me titull “Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonat e hekurudhës ose tramvajet, pjesët dhe plotësuesit e tyre”, tarifa doganore e kodit 8704 10 me titull “makinat e plehërave të projektuara për t’u përdorur në rrugët jashtë autostradave”, përkatësisht kodet 8704 10 11; 8704 10 19 dhe 8704 10 90, me tarifë doganore prej 5 për qind, ndryshohet dhe zëvendësohet me “pa taksë doganore”.

Kodi 8713 me titull “Karrocet e invalidëve të motorizuar ose jo, ose të lëvizura ndryshe mekanikisht”, përkatësisht kodet 8713 10 00 dhe 87 13 90 00 me tarifë doganore 5 për qind, ndryshohet dhe zëvendësohet me “pa taksë doganore”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2832, datë 16.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J

Nr.8713, datë 15.12.2000

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999; nr.8552, datë 18.11.1999; nr.8581, datë 17.2.2000 dhe nr. 8651, datë 28.7.2000 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 shtohet pika 24 me këtë përmbajtje:

“24. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.”

Neni 2

Në nenin 6 shtohet shkronja “t” me këtë përmbajtje:

“t) Taksa mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme llogaritet:

- për ndërtesat: në lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur;
- për pasuritë e tjera të paluajtshme në përqindje mbi vlerën e pasurisë së shitur.

Taksa mbi kalimin e së drejtës të pronësisë në ndërtesa caktohet:

- për Bashkinë e Tiranës në masën 2 000 lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur

të destinuar për biznes, ndërsa për sipërfaqe ndërtimi të shitur të destinuar për banim 1000 lekë për metër katror;

- për bashkitë e kategorive I dhe II në masën 500 lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur;

- për bashkitë e kategorive III dhe IV dhe për të gjitha komunat 200 lekë për metër katror për sipërfaqe ndërtimi të shitur.

Taksa mbi kalimin e pronësisë në pasuritë e tjera të paluajtshme caktohet në masën 2 për qind të vlerës së shitjes.

Taksa mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që shesin pasuri të tilla, me përjashtim të individëve, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat."

Neni 3

Në nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Agjentët e taksave janë të detyruar të derdhin në buxhet taksat e vjela brenda datës 30 të muajit, në të cilin taksat janë arkëtuar."

Pika 10 ndryshohet si vijon:

"10. Për taksën vjetore për licensimet radiotelevizive5 për qind."

- Pas pikës 22 shtohet pika 23, me këtë përmbajtje:

"23. Për taksën mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme3 për qind."

Neni 4

Në nenin 9 shtohet shkronja "r" me këtë përmbajtje:

"r) Për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme ngarkohen zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa provuar pagimin e taksës pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme."

Neni 5

Në nenin 10 shtohet pika 15 me këtë përmbajtje:

"15. Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës të pronësisë për pasuritë e paluajtshme të gjitha sipërfaqet e shitura nga Enti Kombëtar i Banesave."

Neni 6

Në nenin 12, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për taksën e tonazhit për aks dhe për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, afati i fundit i vjeljes së këtyre taksave është data 31 mars. Pas kësaj date Policia e Qarkullimit Rrugor dhe Policia Tatimore kanë të drejtë të bllokojnë mjetin, deri në pagesën e taksës."

Neni 7

Në lidhjen nr.2, në pikën I "Taksat për lëshimin e vizave dhe të dokumenteve të udhëtimit", pika 7 ndryshohet si vijon:

"7. Hyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë për shtetasit e huaj, që nuk kanë nevojë për vizë, reciprocitet, por jo më shumë se 10 USD."

Neni 8

Lidhja nr.7 "Taksat për shërbimet e radiokomunikacioneve" ndryshohet dhe zëvendësohet me lidhjen nr.7, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 9

Në lidhjen nr.8 "Taksa vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

"I. Peshkimi detar (për 1 anije)."

Në pikën 3 "Peshkimi pellagjik me rrethime", paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"- anije 80-200 HP 10 000 lekë."

Në pikën 5 "Peshkimi me mjete selektive dhe trata fundore" ndryshohet si vijon:

"- anije 40-80 HP 15 000 lekë
- anije 81-160 HP 25 000 lekë
- anije 161-200 HP 40 000 lekë
- anije 201-410 HP 50 000 lekë
- anije mbi 410 HP 80 000 lekë."

II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:

Pika 1 ndryshohet si vijon:

"1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor deri 40 HP) 7 000 lekë."

Pika 4 ndryshohet si vijon:

"4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore me mjete të lehta (gabie) për 1 (një) peshkatar 20 000 lekë."

Pika 5 shfuqizohet.

Pas pikës III shtohet pika IV me këtë përmbajtje:

"IV. "Akuakultura:

1. Kultivimi i midhjeve për një implant 10 000 lekë

Kultivimi i peshqve me impiante në

det, në liqene, në rezervuarë 1 000 lekë

3. Akuakulturë me impiante në tokë 10 000 lekë"

Neni 10

Kudo, ku në ligj përmenden fjalët "Këshilli i rrethit, bashkisë apo komunës" zëvendësohen me fjalët: "Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli komunal".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2833, datë 16.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIDHJA NR.7

TAKSAT PËR SHËRBIMET E RADIOKOMUNIKACIONIT

PJESA A

TAKSAT PËR SHËRBIMET PRIVATE TË RADIOKOMUNIKACIONEVE

I. Shërbimi aeronautik

- | | |
|--------------------------------|--------------------|
| 1. Stacion bazë në tokë | 10 000 lekë në vit |
| 2. Stacion i lëvizshëm në tokë | 7 500 lekë në vit |

3. Stacion portativ në tokë	5 000 lekë në vit
4. Terminal satelitor në avion	40 000 lekë në vit
5. Radaret dhe pajisjet e radionavigimit aeronautik	3 000 lekë në vit për çdo pajisje
6. Stacionet e avionit me aftësi ngritëse	
deri 3 200 kg	5 000 lekë në vit
mbi 3 200-14000 kg	40 000 lekë në vit
mbi 14 000 kg	80 000 lekë në vit

II. Shërbimi detar

1. Stacion bregdetar	10 000 lekë në vit për çdo stacion bazë
2. Radarë dhe pajisje radionavigimi	2 500 lekë në vit për çdo pajisje
3. Radio për operacione portuale	1 500 lekë në vit për çdo radio
4. Stacion bazë në anije(HF,VHF,UHF)	5 000 lekë në vit për çdo radio
5. Stacion portativ (VHF) në anije	1 000 lekë në vit për çdo radio.
6.Terminal satelitor në anije INMARSAT	3 000 lekë në vit

III. Shërbimi satelitor

1. Stacion tokësor fiks	
- analog me gjerësi brezi deri 100 kHz	150 000 lekë në vit
- me gjerësi brezi mbi 100 deri 1MFz	500 000 lekë në vit
- me gjerësi brezi mbi 1 MHz	1 200 000 lekë në vit
- dixhital me kapacitet deri 64 kbps	25 000 lekë në vit
deri 2 Mb/s	75 000 lekë në vit
mbi 2Mb/s deri8Mb/s	300 000 lekë në vit
mbi 8 Mb/s	700 000 lekë në vit
2. Stacion Tokësor i transportueshem (në automjete)	800.000 lekë në vit
3. Stacion portativ VSAT (çantë, valixhe)	30.000 lekë në vit
4. Stacion tokësor i transportueshëm me afat qendrimi deri në një muaj në vendin tonë	60 000 lekë në vit
5. Stacion portativ VSAT (çantë, valixhe) me afat qëndrimi deri 6 muaj në vendin tonë	15 000 lekë në vit

IV. Shërbimi i lëvizshëm në Tokë.

- Shërbim i lëvizshëm (PMR), në brezin 146 MHz deri 470 MHz
- A. Sisteme dupleks e gjysmë dupleks me gjerësi kanali deri 12.5 Khz:

Zona e shërbimit	Lidhje midis dy stacioneve përsëritës	Lidhje stacion fiks me stacion të lëvizshëm dhe/ose stacion i levizshem me stacion të lëvizshëm
deri në 10 km	15 000 lekë në vit	10 000 lekë në vit
mbi 10 deri 30 km	25 000 lekë në vit	20 000 lekë në vit
mbi 30 deri 50 km	55 000 lekë në vit	40 000 lekë në vit
mbi 50 km	80 000 lekë në vit	65 000 lekë në vit

Ky nivel taksash zbatohet për sisteme që kanë deri në 10 stacione të lëvizshëm.

B. Për sisteme të njëjtë me ato të pikës 1.A , por me numër më të madh stacionesh të lëvizshëm , zbatohen taksat e mëposhtme:

- | | |
|-------------------------------------|--|
| - për sistem me 11 deri 25 stacione | taksës përkatëse të pikës 1.A i shtohet po ajo vlerë me koeficient reduktimi 0.8 |
| - për sistem me 26 deri 40 stacione | taksës së mësipërme i shtohet taksa e pikës 1.A me koeficient reduktimi 0.6 |
| - për sisteme që ka mbi 40 stacione | taksës së mësipërme i shtohet taksa e pikës 1.A me koeficient reduktimi 0.4 |

C. Për sistemet me gjerësi kanali 25 Khz taksa e llogaritur si në 1.A dhe 1.B të shumëzohet me koeficientin 1.5

D. Për sistemet simplekse zbatohen taksat përkatëse të pikave 1.A dhe 1.B me koeficient reduktimi 0.5

2. Sistem "trunk " kombëtar

- 100 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 12.5 kHz
- 150 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 25 kHz

3. Sistemi "trunk" rajonal

- 30 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 12.5 kHz
- 40 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 25 kHz

4. Sistem TETRA

- 50 000 lekë në vit për sistem kombëtar për çdo kanal 25 Khz
- 20 000 lekë në vit për sistem rajonal për çdo kanal 25 Khz

V. Shërbimi fiks për operatorët e telekomunikacioneve.

Lidhje dy drejtimshë:

Sistem në brezin deri 80 MHz	80 000 lekë në vit për çdo kanal 3 kHz
Sistem në brezin 80-500 MHz	40 000 lekë në vit për çdo kanal 25 kHz
Sistem në brezin 500-1000 MHz	25 000 lekë në vit për çdo kanal 200 kHz
	50 000 lekë në vit për çdo kanal mbi 200 kHz.

Sistem në brezin mbi 1000 MHz

- | | |
|---|--------------------|
| a) analog : për çdo kanal me gjerësi deri 1 MHz | 30 000 lekë në vit |
| për çdo kanal me gjerësi deri 10 MHz | 40 000 lekë në vit |
| për çdo kanal me gjerësi mbi 10 MHz | 60 000 lekë në vit |
| b) dixhital: për kapacitet deri 128 kb/s | 5 000 lekë në vit |
| për kapacitet deri 2 Mb/s | 20 000 lekë në vit |
| për kapacitet deri 8 Mb/s | 30 000 lekë në vit |
| për kapacitet deri 34 Mb/s | 40 000 lekë në vit |
| për kapacitet mbi 34 Mb/s | 50 000 lekë në vit |

Shënime :

- *Me lokal do të kuptohet mbulimi i territorit në nivel rrethi
- *Me rajonal do të kuptohet mbulimi i territorit të disa rretheve.
- *Me kombëtar do të kuptohet mbulimi i mbi 50% të territorit shqiptar.

PJESA B

TAKSAT PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË RADIOKOMUNIKACIONEVE

1. Shërbimi fiks tokësor

- Për përdorim jo ekskluziv të frekuencave

Sistem analog (radio-rele)	3 000 lekë/vit për çdo kanal telefonik 3kHz
Sistem dixhital (radio-rele)	1 500 lekë/vit për çdo kanal telefonik 64kb/s
Sistem dixhital (radio rele)	20 000 lekë/vit për çdo link 2Mbit/sek
Sisteme radio të telefonisë rurale	1 000 lekë/vit për çdo kanal telefonik

- Për përdorim ekskluziv të frekuencave në nivel kombëtar

Në brezin UHF	100 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin 1-5 Ghz	60 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin 5-11 Ghz	40 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin mbi 11 Ghz	20 000 lekë/vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur

2. Shërbim fiks satelitor

Sistem analog	5000 lekë/vit për çdo kanal telefonik 3kHz
Sistem dixhital	3000 lekë/vit për çdo kanal telefonik 64 kb/s

3. Shërbim i lajmërimit të personit (Pager)

Lidhje ndërmjet stacioneve fikse (bazë-përsëritës)	40 000 lekë/vit për çdo hop radio
Për çdo stacion bazë	30 000 lekë/vit

4. Shërbimi i lëvizshëm telefonik (GSM)

150 000 lekë/vit për çdo kanal 200 kHz

5. Shërbimi internet

Lidhje me sistem satelitor	10 000 lekë/vit për çdo njësi 64 kb/s
Lidhje me sistem radio-rele	500 lekë/vit për çdo njësi 64 kb/s

6. Shërbimi telefonik satelitor (GMPCS)

4 000 USD/vit

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 16.12.2000
Doli nga shtypi më 16.12.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e "Tipografisë Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë